



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.7, datë 16.01.2023

MBI

**“VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKURORIN
ELION MUSTAJ, KANDIDAT PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË FIER”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës, nenet 159, pika 1 dhe 2 germa “a” dhe 189, pika 1, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 48 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikën 5 të nenit 9 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” dhe në germën “ç”, pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokurorin Elion Mustafaj, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokurorin Elion Mustafaj, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, sipas relacionit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Lejimin e kandidatit prokuror Elion Mustafaj të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
3. Të njoftohet për këtë vendim zoti Elion Mustafaj.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 16.01.2023.


KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla



ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani



ANËTAR
Bujan Sheshi



ANËTAR
Nurihan Sejti



ANËTAR
Elaida Goxhi



ANËTAR
Esmeralda Keshi



ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza



ANËTAR
Mirela Bogdani



ANËTAR
Arta Mandro

